

VENDIM
Nr.1144, datë 13.11.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 208 dhe 212 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “d” e pikës 1 të nenit 247 të kreut 2 “Magazinimi doganor” të titullit III, të pjesës II të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“d) Në çdo rast, hyrja e mallrave në regjimin e magazinimit doganor duhet të mbulohet me garanci, sipas njërës prej formave të garancive, të përcaktuara në Kodin Doganor, dhe konkretisht:

i) Depozitë në të holla, kur shuma e kërkuar si garanci nuk e kalon vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ii) Kur shuma e kërkuar si garanci e kalon vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë lekë), garantimi do të bëhet përmes formave të mëposhtme:

ii/a) Depozitë në të holla ose

ii/b) Depozitë në të holla deri në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë dhe pjesa e mbetur, deri në masën e kërkuar të garancisë, mund të plotësohet përmes njërës nga format e garancisë, si më poshtë vijon:

- dorëzani ose

- mall gjendje(stok) në kushte ruajtjeje e sigurie (plumbosje doganore) brenda mjediseve të miratuara, me kusht që vlera e tij në çdo kohë të jetë jo më pak se trefishi i shumës së kërkuar si garanci.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha